

UNIVERSITETI I MITROVICËS ‘ISA BOLETINI’

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI PARASHKOLLOR



PUNIM DIPLOME

Eroida Istrefi

Mitrovicë, 2020

UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI PARASHKOLLOR



PUNIM DIPLOME

**Krahasimi mes dy sistemeve të edukimit
parashkollor: Kosovar dhe amerikan – Rast
studimi në rrethin e Mitrovicës**

Mentorja:

Prof.Ass.Dr.EditaBekteshi

Kandidatja:

Eroida Istrefi

Mitrovicë,2020

UNIVERSITY OF MITROVICA ‘ISA BOLETINI’

FACULTY OF EDUCATION

PRESCHOOL EDUCATION DEPARTMENT



DIPLOMA THESIS

Comparison between two preschool education systems: Kosovar and American ones – Case study in Mitrovica district

ThesisSupervisor:

Prof.Ass.Dr.EditaBekteshi

Student:

Eroida Istrefi

Mitrovicë,2020

UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI PARASHKOLLOR



PUNIM DIPLOME

Lënda:

Gjuhë Angleze

Titulli i punimit:

Krahasimi mes dy sistemeve të edukimit
parashkollor : Kosovar dhe amerikan – Rast studimi në rrethin e Mitrovicës

Emri dhe Mbiemri:

Eroida Istrefi

Statusi i Studentit:

I rregullt

Numri i amzës (ID Regjistri): 1506021034

Niveli i studimeve:

Bachelor

Programi i studimit:

Parashkollor

Mentori/ja i/e punimit:

Prof.Ass.Dr. Edita Bekteshi

Aprovuar prej komisionit:

1. Emri Mbiemri, Titulli/ _____,mentor
2. Emri Mbiemri, Titulli/ _____,anëtar
3. Emri,Mbiemri, Titulli/ _____,anëtar

Data e aprovimit: _____

Deklaratë e autorësisë

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim me titull “Krahasimi mes dy sistemeve të edukimit parashkollor: Kosovar dhe amerikan – Rast studimi në rrethin e Mitrovicës” është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose në pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

Eroida Istrefi

FALËNDERIME

Falënderimi i takon Zotit që më mundësoi të arrij deri këtu ,pastaj familjes time të cilës i detyrohem shumë për fillimin dhe finalizimin me sukses të këtij udhëtimi.

Gjithashtu do të dëshiroja të shprehë mirënjohje dhe falënderim special për mentoren time Prof. Dr.Edita Bekteshi, për ndihmën dhe mbështetjen e çmuar që më ofroi për gjatë gjithë kohës së punës time në këtë temë si dhe për kontributin në finalizimin e saj, e cila është produkt i shumë konsultimeve, këshillimi dhe përkrahje nga ana e saj.

Realizimi i këtij punimi nuk do të ishte i mundur pa njohuri të thella të kësaj fushe, prandaj një mirënjohje dhe falënderim të veçantë dëshiroj ta shpreh për Universitetin e Mitrovicës dhe të gjithë profesorët e fakultetit të edukimit që kontribuan në formimin tim profesional.

Dedikim

Tërë punimin e bërë ja dedikoj familjes time që ka qenë gjithmonë krah meje duke më përkrahur si financiarisht ashtu edhe moralisht për të arritur deri këtu. Përkrahja e familjes time ka qenë që nga fëmijëria e që vazhdon ende që të më përkrahin në të gjitha aspektet.

Përmbajtja

Deklaratë e autorsisë	V
Falenderime	VI
Dedikim	VII
Abstrakt	X
Abstract	XI
1.HYRJJE	12
1.1 Qëllimet e hulumtimit	14
1.2 Rëndësia e edukimit parashkollor	15
1.2.1 Historia e edukimit parashkollor.....	15
1.2.2 Karakteristikat e edukimit parashkollor.....	16
1.2.3 Qëllimet e edukimit parashkollor.....	17
1.3 Edukimi parashkollor në Kosovë.....	20
1.3.1 Qëllimet e edukimit parashkollor në Kosovë.....	21
1.4 Edukimi parashkollor në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.....	23
1.4.1 Qëllimet e edukimit parashkollor në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.....	25
2. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT.....	26
2.1 Pjesëmarrësit.....	26
2.2 Instrumentet.....	27
2.3 Mënyra e mbledhjes së të dhënave.....	27
3. REZULTATET.....	28
4. DISKUTIME.....	39
5. KONKLUDIME DHE REKOMANDIME.....	41
6. Referencat.....	42
7.Shtojca 1.....	44

8.Shtojca 2.	49
-------------------	----

Lista e tabelave dhe grafikave

Tabela 1.Shkallët e edukimit dhe përgatitja për tregun e punës në Kosovë.....	22
Tabela 2. Shkallët e edukimit dhe përgatitja për tregun e punës në SHBA.....	23
Tabela 3a. Edukimit parashkollorë në Kosovë.....	35
Tabela 3b.Edukimi parashkollorë në SHBA.....	35
Tabela 4a.Aktivitetet dhe detyrat e fëmijëve në Kosovë.....	36
Tabela 4b. Mësimet e fëmijëve në SHBA	37
Grafika 1. Përqindja e pjesmarrësve.....	28
Grafika 2. Institucioni ku punojnë.....	28
Grafika 3. Niveli i trajnimeve.....	29
Grafika 4. Shpërndarja e edukatoreve në bazë të institucioneve.....	29
Grafika 5. Mënyra e punës së fëmijëve	30
Grafika 6. Koha e kaluar në aktivitete.....	30
Grafika 7.Qendra e aktiviteteve në klasë.....	31
Grafika 8. Aktivitete të përdorura nga fëmijët.....	31
Grafika 9. Niveli i kërkesave të prindërve.....	32
Grafika 10. Përdorimi i detyrave nga fëmijët.....	33
Grafika 11. Përdorimi i kurrikulës.....	33
Grafika 12. Organizimi i aktiviteteve në natyrë.....	33
Grafika 13. Metoda për mësimdhënie.....	34

Abstrakt

Edukata është tërësi e cilësive shpirtërore, mendore, fizike, veti morale, tiparet karakterit e të vullnetit, zakonet që i fiton njeriu në ndikimin sistematik, të familjes, shkollës, shoqërisë dhe duke mësuar e punuar. Pra, edukata është formim i përgjithshëm i njeriut, kurse me edukim nënkuptojmë themelet e një sistemi të mirë të arsimit.

Edukimi parashkollor i institucionalizuar është hallka e parë e sistemit arsimor dhe realizohet në institucionet parashkollore. Fëmija parashkollor mëson, aftësohet e shkathtësohet përmes përmbajtjeve të strukturuar dhe përmes jetës bashkëvepruese në institucion parashkollor. Institucionet parashkollore janë demokratike, ofrojnë shanse të barabarta të edukimit për të gjithë fëmijët pavarësisht nga përkatësia gjinore, etnike, fetare, racore, etj.. Gjatë edukimit parashkollor, fëmijet mësojnë për mjedisin rrethues, njerzit, dhe natyrën si dhe diversitetin e tyre.

Prandaj edhe në këtë punim flitet për periudhën parashkollore e cila konsiderohet si periudha më e rëndësishme ku fëmija krijon personalitetin e tyre. Gjithashtu qëllimi i këtij punimit është të krahasoj dy sistemet e edukimit parashkollor: Kosovë dhe Amerikë duke analizuar qëllimet e edukimit parashkollor, ngjashmëritë dhe dallimet, historinë e edukimit, e karakteristikat.

Hulumtimi është zhvilluar në shkollat e qytetit të Mitrovicës, ku popullatë ishin kryesisht edukatorët të cilët punojnë me fëmijet e moshave 3-4, 4-5, 5-6 ndërsa si mostër janë përzgjedhur 10 edukatorët të cilat i janë përgjigjur një pyetësori, i cili ka qenë kombinimin i dy pyetësoreve, atij të Erasmus+ dhe Instituti Pedagogjik i Kosovës, kurse analizat statistikore janë: analiza përshkruese T-test dhe të dhënat janë përpunuar nga Pako Statistikore e Shkencave Sociale (SPSS)-version 2020.

Në bazë të të dhënave të nxjerra nga pyetësori, atëherë gjetjet tregojnë se mosha e fëmijëve është 4-5 dhe 5-6 vjeç, kryesisht numri i fëmijëve në klasë është 10-20 fëmijë, në shumicën e shkollave punojnë nga dy edukatorët, puna me fëmijët zakonisht është në grupe edhe individuale ku fëmijët kalojnë në aktivitete 20 minuta maksimumi.

Aktivitetet në natyrë janë shumë të dobishme për fëmijët andaj edhe edukatorët disa prej tyre e praktikojnë. Ato tregojnë se nuk kanë ndonjë problem për ta ndjekur kurrikulen, dhe sa i përket metodave që do ju shërbente edukatorëve gjatë mësimdhënies kanë përzgjedhur aktivitete të ndryshme për fëmijët të cilat mund të ndërliken gjatë mësimin.

Gjithashtu, edukatorët ishin të pajtimit për të adaptuar praktikat arsimore të SHBA-së kryesisht sa i përket numrit të fëmijëve dhe mjeteve të punës.

Fjalët kyçe: edukimi parashkollor, Kosovë, SHBA

Abstract

Education is a unity of spiritual, mental, physical qualities, moral attributes, will traits, habits that people earns under systematic influence, of family, school, society and by learning and working. Education is general formation of people whereas with education we understand the foundations of a decent education system.

Institutional preschool education is the first link of the system in the preschool institutions. The preschoolers learns and become capale through structured contents and through cooperative life in a preschool institutions.

Preschool institutions are democratic, offer equal opportunities for education for all children independently of the gender, ethnicity, religion, race, etc.

During preschool education children learn about sorroundin environment, people and nature, also the nature and their diversity.

This thesis is about preschool period, which is considered the mos important period where the child creates his personality, also the aim of this thesis is to compare two systems of preschool education: kosovarian and american, by analyzing the aims of preschool education, simibrities and differences, history of education, characteristics.

Research is developed in the schools of the city of Mitrovica, where the population is mainly the preschool teachers who work with children of 3-4, 4-5, 5-6 of age, whereas as samples 10 teachers have been chosen.

The questionnaire used in this research was a combination of two questionairs, the Erasmus+ and the Pedagogical Institution of Kosova.Statistical analysis are: descriptive analysis T-test and the data has been elaborated by version of Statistical Package of the Social Sciences (SPSS).

According to the data abstracted by the questionnaire the findings show that the children's age is 4-5 and 5-6 years old, mainly number of children in class is 10-20 children, most of the schools operate two preschool teachers, the work with children is usually in groups and individual, where the children spend 20 minutes in activities. Activites in nature are very helpful for children so also the teachers use it. They say that there are no problems in pursuing the curriculum, and as the methods are concerned which are used by the teachers during the teachings they have chosen different activities for children which can be corelated during the process of teaching. Preschool teachers have agreed to adapt educational practices of the USA, mainly concerning the number of children and teaching tools

.Key words: Preschool education, Kosova, USA

1. HYRJJE

“Edukimi nuk është një përgatitje për jetën, edukimi është vetë jeta” – John Dewey

Investimi më i duhur që një qeveri e një vendi mund të bëjë është investimi në edukim të hershëm të fëmijëve, vlera e të cilit do të kthehet shumëfish më e madhe se sa që është investuar.

Sipas ekonomisti James Heckman, fitues i çmimit Nobel programi parashkollor është investimi më i duhur respektivisht ai pohon “Një dollar i shpenzuar në programe parashkollor gjeneron kthim më të madh të investimeve se investimi i njëjtë në programe shkollor”. Gjithashtu edhe Heckman (2010) e perkrah kete mendim, duke theksuar se: “Çdo investim që është bërë tek fëmija nga mosha 0-3 vjeç, konsiderohet investim që vlen sa krejt jeta e atij fëmiju”.

Edukimi parashkollor përfshin edukimin e fëmijëve nga mosha 0-6 vjeç. Ky përfshin periudhën kryesore e cila ndihmon në zhvillimin e fëmijëve si në aspektin social, emocional, intelektual apo moral. Pra, nga ajo që u tha më lart shohim se edukimi parashkollor përfshin periudhën kur fëmijët fillojnë të krijojnë personalitetin e tyre, e gjithçka që mësohet gjatë kësaj kohe arrihet nëpërmjet lojës. Sepse në edukimin parashkollor nëpërmjet lojërave që zhvillohen aty ndihmon në përmirësimin e normave sociale dhe morale të cilat fëmijët i përcjellin si në familje, shkollë dhe komunitet.

Ekzistojnë shkolla të shumta me mësues, pedagogë, psikologë të ndryshëm, mësime të ndryshme, por kryesisht punën e bëjnë për arsye të njëjta. Puna e tyre është që gjithmonë të përgatisin kuadro të reja duke përmirësuar aftësinë e fëmijëve për të mësuar, por fillimi i suksesit për një fëmijë fillon nga edukimi parashkollor, andaj edhe duhet pasur kujdes të madh rreth mësimeve dhe aktiviteteve që shpalosen para tyre.

Kjo është edhe e zyrtarizuar në nivel global ku thuhet se objektivat e përgjithshme të arsimit parashkollor përshkruhen në legjislacionin që rregullon arsimin bazë. Qëllimi i arsimit parashkollor është të mbështesë rritjen e fëmijëve në njerëzim dhe anëtarësim etik të përgjegjshëm të shoqërisë dhe t’u sigurojë atyre njohuri dhe aftësi të nevojshme në jetë. Për më tepër, qëllimi i arsimit parashkollor, si pjesë e edukimit dhe kujdesit të hershëm të fëmijëve, është të përmirësojë aftësinë e fëmijëve për të mësuar (European Commission, 2020).

Kurse në nivelin kosovarë, sipas Ligjit mbi edukimin parashkollor (2006), qëllimet e edukimit parashkollor në Kosovë janë: Zhvillimi i personalitetit të fëmijës, zotërimi i aftësive dhe kompetencave komunikuese, shprehëse, logjike dhe vepruese e ndërvepruese. Ndër të tjera : Të inkurajohen aftësia që të kuptohet dhe të pranohet vetvetja dhe të tjerët,

të transferohet dituria në fusha të ndryshme të shkencës dhe jetës së përditshme (Ligji mbi edukimin parashkollor ne Kosove, 2006)

Ka shumë rëndësi të madhe aktivitetet që bëhen në këto kopshte, pasi që nëpërmjet atyre aktiviteteve fëmijë mësojnë shumë që në të ardhmen do të ju ndihmojnë shumë. Në bazë të aktiviteteve shihet edhe qëllimi ynë se çka dëshirojmë të arrijmë nëpërmjet atyre aktiviteteve.

Duke u bazuar në të dhënat e një publikimi nga Universiteti i Minnesotas (Corsi-Bunker, 2019). për sistemin e edukimit në SHBA theksohet se atje edukimi parashkollor përfshinë kopshtin e fëmijëve (çerdhet), shkollën e lojërave dhe shkollat e tjera edukative të fëmijëve. Programet parashkollore zakonisht ofrojnë seanca dy ose tre orë në ditë, disa ditë në javë. Këto programme nuk përdoren kryesisht për kujdesin e fëmijëve, por përkundrazi u ofrojnë fëmijëve një mundësi në baza të pjesshme për të bashkëvepruar me fëmijët e tjerë dhe për t'u përgatitur për kopshtin e fëmijëve. Regjistrimi zakonisht është i kufizuar te fëmijët 3 deri në 5 vjeç

Shkollat parashkollore dallojnë veten duke u përqendruar në mënyrë të barabartë në korrijen e zhvillimit shoqërorë të një fëmije, zhvillimin fizik, zhvillimin emocional dhe zhvillimin njohës. Ata zakonisht ndjekin një seri standardesh mësimore të krijuara nga organizata në formimin e kurrikulës dhe aktiviteteve/qëllimeve mësimore (Corsi-Bunker, 2019).

Një institucion parashkollor i mirëfilltë është ai institucion i cili balancon karakteristikat që mbështesin zhvillimin individual të fëmijës me vlera shoqërore dhe me vetëdijësimin për atë që e rrethon. Përveç kësaj, ai i përforcon aftësitë personale të poseduara dhe të cilat kërkohen për shoqërinë dhe e ngritë nivelin e kulturës demokratike.

Kujdesi për fëmijë në parashkollor në mënyre tipike i referohet programeve ditore të plota nën kujdesin e mirëqenies sociale ose programe të pavarura që korrespondojnë me orët tradicionale të punës prej 09:00 të mëngjesi deri në 17:00 dhe janë të hapura pesë ditë në javë për vitin e plotë. Natyrisht, disa qendra të kujdesit për fëmijët ofrojnë kujdes për foshnjat të tjerët kujdesen vetëm për fëmijët e vegjël (1-2 vjeç) dhe/ose fëmijët e moshës parashkollore (të moshës 3-5 vjeç (Karp, 2003).

Duke u bazuar në të dhënat e mbledhura, në SHBA vetëm një edukatore mund të punojë me 15 fëmijë, por nëse numri i fëmijëve është 12-20 në parashkollorë atëherë duhet të punojnë 2 edukatore.

Shumica e parashkollorëve kanë një sërë qëllimesh dhe një filozofi dhe secili mësues duhet t'i përmbahet. Në disa raste, mësuesit ndjekin ato udhëzime të përgjithshme në një mënyrë informale. Sidoqoftë, në shumë raste mësuesit duhet të plotësojnë planet e mësimit dhe rubrikat për vlerësimin e progresit të fëmijës. E për këto janë kurrikulat ku shumë parashkollorë funksionojnë vetëm për disa orë në ditë, ndërsa të tjerët (sidomos në mjediset e shkollës publike) funksionojnë për ditë shumë më të gjata.

Gjatë çdo dite të caktuar, fëmijët parashkollorë ka të ngjarë të marrin pjesë në: Aktivitete specifike të tilla si koha e rrethit, koha e këngës, koha e kalendarit, koha e lojës aktive,

koha e historisë dhe koha e zanatit. Udhëtime në terren të dizajnuara për të përmirësuar një mësim, të tilla si një udhëtim në zyrën postare për të mësuar në lidhje me postën ose një vizitë në dyqan ushqimor për të mësuar në lidhje me zgjedhjen e ushqimeve të shëndetshme.

Sesione me folës të ftuar specialë të cilët janë sjellë për të dhënë me shumë detaje në një orë mësimore, të tilla si një oficer policie për të folur për sigurinë ose një dentist për të diskutuar shëndetin oral. Natyrisht, një kurrikulë parashkollore mund të përfshijë gjithashtu detyrat e shtëpisë që i janë dhënë fëmijës për të përfocuar ato që janë mësuar në klasë, por disa edukatorë kanë thënë se detyrat e shtëpisë janë të panevojshme në një moshë kaq të re.

Niveli parashkollorë nuk u përmbahen të njëjtave udhëzime arsimore, ato synojnë të përgatisin nxënësit për arsimin e mëtejshëm. Kjo do të thotë që shumë edukatore të mirë punojnë në fushat kryesore të aftësive si këto :

Letra, numrat, forma, ngjyrat, prerja, ngjyrosje, shkrimi i shkronjave dhe numrave, renditja e objekteve, vizatim, ngjitje, ndarja, bashkëpunimi (Williams, 2020).

1.1 Qëllimet e hulumtimit

Duke u nisur nga ajo se çka u tha më lart për edukimin parashkollor në SHBA, si një shtet i fuqishëm dhe ai i Kosovës, vendi ku jetojmë ne, nëpërmjet këtij punimi do mundohemi që duke analizuar të dhënat që do i marrim, të dalim me një përfundim për dallimin në mes të edukimit parashkollor të Shteteve të Bashkuara të Amerikës me atë të Kosovës dhe të njihemi për së afërmi me qëllimet e edukimit parashkollor tek të dyjat vendet.

Më saktësisht, ky hulumtim do të mundohet të përgjigjet në këto pyetje hulumtuese:

1. A ka dallime të mëdha në mes të edukimit parashkollor në SHBA dhe në Kosovë?
2. A do ndryshonin sistemin parashkollor edukatorët kosovare, respektivisht a do e merrnin si model edukimin parafillor të SHBA-ve.

Punimi në përfundim do të ketë një rëndësi të madhe, poashtu që të shërbejë shumë të njihemi me politikat arsimore në Kosovë dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Për të arritur rezultate të suksesshme të arsimit duhet filluar investimin që në fëmijërinë e hershme, pra që nga parafillori, prandaj edhe me anë të këtij hulumtimi do të mund të shohim ndryshime dhe ngjashmëritë e këtyre dy shteteve. Punimi do të ketë rëndësi edhe në praktike me rekomandimet për masat që duhet të merren, sidomos masat institucionale të politikave rreth mbështetjes së arsimit në Kosovën me fokus të veçantë në edukimin parashkollor.

1.2 Rëndësia e edukimit parashkollor

Rëndësia e edukimit parashkollor dita ditës vetëm se është duke u rritur. Aq sa është i rëndësishëm edukimi parashkollor, është bërë edhe i domosdoshëm pasiqë tani në kohën që po jetojmë shumica e prindërve janë duke punuar andaj edhe paraqitet nevoja për çerdhe, parashkollor, etj.

Në trojet tona shqiptare dhe në kulturën tonë edhe pse prindërit kanë punuar prapë se prapë fëmijët kanë qëndruar në shtëpi, janë rritur dhe edukuar nga prindërit e moshuar apo edhe familjarë të tjerë të familjës së ngushtë. Kjo metodë e edukimit sa i ka efektet pozitive ka edhe efekte të shumta negative, pasiqë fëmijët pas rritjes së tyre dhe momentin për të vazhduar në shkollën fillore e tutje nuk do të jenë të barabartë sikurse moshatarët e tyre. Qëndrimi në shtëpi i fëmijëve të vegjël që nga lindja e deri tek moshë 6-7 vjeçare edhe kur fillojnë klasën e parë ndikon shumë në fëmijën. Fëmijët nuk do të kenë mungesën e ngrohtësisë dhe dashurisë familjare pasiqë do të jenë vazhdimisht me prindërit, gjyshërit e personat e tjerë, ndoshta edhe një kujdes më të shtuar sesa që do të kishin në çerdhe, por prap se prapë fëmijët ndoshta edhe do t'i mësojnë disa gjëra që nuk duhet mësuar dhe nuk i mësojnë disa që duhet mësuar. Ata do t'i mësojnë disa gjëra tradicionale dhe do të mbeten me ato njohur përderisa moshatarët e tyre në çerdhe dhe parashkollor do të ambientohen me shkollën, shoqërinë, mësimet, botën moderne e poashtu edhe do të jenë më larg TV, telefonave apo lodrave të dëmshme për shëndet dhe për trurin e tyre (Sverdlov et.al. 2010). Domethënë se zhvillimi i fëmijëve në moshë parashkollore karakterizohet nga ndryshimet thelbësore në çdo fushë: fizike, emocionale, sociale, gjuhësore dhe njohëse. Zhvillimi nuk është vetëm biologjik – ai gjithashtu buron nga përvoja e fituar dhe mësuar nga vet fëmija dhe këto ndryshime domethënëse janë të ndërlidhura dhe me ndikim reciprok (Sverdlov et.al. 2010).

1.2.1 Historia e edukimit parashkollor

Edukimi parashkollor është një institucion arsimor që ofron arsim në kohën e hershme të fëmijërisë, para se ata të fillojnë arsimin që është i detyrueshëm për ta. Në vende të ndryshme të botës ka emra të ndryshëm se si i quajnë shkollat, çerdhet apo shtëpitë ku mësojnë fëmijët nga 0 deri në 6 vjeç. Mirëpo, edhe pse emërtimi është i ndryshëm nga vendi në vend, qëllimi është i njëjtë në tërë botën.

Sipas projektit Pre-K Now (Pew Charitable Trusts) që është i projektuar për edukimin parashkollor, nocioni i edukimit parashkollor ka filluar në fillim të viteve 1800 .

Në vitin 1926 u krijua Shoqata Kombëtare e Edukimit të Fëmijëve të Rinj e përkushtuar në përmirësimin e mirëqenies së të gjithë fëmijëve të vegjël dhe përqendrimit në cilësinë e arsimit dhe shërbimeve të zhvillimit që u ofrohen fëmijëve nga lindja deri në moshën tetë vjeç (Lipoff, 2011).

Sa i përket rastit në Kosovë, vetëm pas vitit 2000, institucionet shtetërore filluan t'i kushtojnë më shumë rëndësi edukimit parashkollor. Siç dihet infrastruktura ligjore dhe ajo

profesionale mungonte për të gjitha nivelet, por, për edukimin parashkollor në veçanti, gjendja ishte më e rëndë duke marrë parasysh se ky nivel i arsimit nuk ishte i përfshirë më parë në sistemin paralel të arsimit.

Edukimi parashkollor është përkrahur në vazhdimësi nga partnerë zhvillimor ndërkombëtarë si UNICEF, Save the Children, Caritasi Zvicëran, Banka Botërore, Bashkimi Evropian si dhe nga organizata jo-qeveritare të tjera të cilat synonin gjithëpërfshirjen në edukimin parashkollor dhe përmirësimin e cilësisë së këtij niveli.

Kuvendi i Kosovës, në vitin 2006 miratoi Ligjin Nr. 02/L52 për Edukimin Parashkollor i cili për herë të parë rregullonte organizimin e edukimit parashkollor në Kosovë. Me miratimin e këtij ligji, gradualisht u vendosën shtyllat për një edukim më të organizuar dhe më cilësor (KEEN, 2018).

1.2.2 Karakteristikat e edukimit parashkollor

Rëndësia e edukimit parashkollor si dhe qëllimet u paraqitën më lartë në këtë punim, ndërsa tani do paraqesin karakteristikat e edukimit parashkollor. Këto karakteristika janë të lidhura me qëllimet dhe rëndësinë, pasi që sikurse qëllimet ashtu edhe rëndësia e edukimit rrjedh nga karakteristikat që i ka edukimi parashkollor.

Departamenti Amerikan i Edukimit pranon që efektiviteti i një programi të fëmijërisë së hershme varet nga një numër faktorësh:

- Një mjedis i përshtatshëm;
- Planifikim i vazhdueshëm
- Përfshirja e prindërve;
- Praktikat e duhura të grupimit;
- Një staf cilësor.

Kjo agjenci federale gjithashtu njeh karakteristikat shtesë të një programi të arsimit të hershëm me cilësi të lartë:

- Një ekuilibër midis aktiviteteve individuale, grupeve të vogla dhe grupeve të mëdha;
- Një program i ekuilibruar që nuk rezulton në fëmijë të nxituar ose të lodhur;
- Një themel i fortë në zhvillimin e gjuhës, shkrim-leximin e hershëm dhe matematikën e hershme;
- Qasje në një mjedis të sigurt, ushqyes dhe stimulues së bashku me mbikëqyrjen dhe drejtimin e të rriturve kompetent të kujdesshëm;
- Mësuesit dhe stafi që komunikojnë rregullisht me prindërit dhe kujdestarët;
- Mësuesit që kontrollojnë shpesh përparimin e fëmijëve (Williams, 2020).

1.2.3 Qëllimet e edukimit parashkollor

Secila punë, projekt, veprim e ka një qëllim e që nëpërmjet arritjes së atij/atyre qëllimeve do të mund që të kemi sukses të mëtutjeshëm. Edukimi parashkollor i ka qëllimet e veta, por se secili institucion, shkollë, çerdhe, vend i kanë disa qëllime që pak a shumë do të ndryshonin nga njëra tjetra.

Të gjitha programet duhet të kenë qëllime për të udhëhequr aktivitetet dhe për të siguruar një bazë për metodologjitë e mësimdhënies. Pa qëllime është e lehtë të përfundosh duke dhënë mësim për çdo gjë. Megjithëse, qëllimet e shkollave parashkollore ndryshojnë sipas programeve shtetërore dhe individuale, të gjitha duhet të kenë disa qëllime thelbësore.

- **Shkathtësi sociale dhe ndërpersonale**

Qeniet njerëzore janë shoqërore dhe shumë nga mësimet e studentëve përfshijnë ndërveprime sociale:

- ✓ Të shoqërohen me fëmijë dhe të rriturit e tjerë dhe të zhvillojmëmarrëdhënie të mira me mësuesit;
- ✓ Ndihma për të tjerët dhe zhvillimi i qëndrimeve të kujdesshme;
- ✓ Të luajnë dhe punojnë në bashkëpunim;
- ✓ Ndjekim rregullat e klasës (Texas Education Agency,2007).

- **Vetëndihmë dhe aftësi ndërfaqësore**

Fëmijët duhet të mësojnë se si të menaxhojnë sjelljet e tyre dhe punët e tyre:

- ✓ Kujdesi për nevojat personale, të tilla si veshja (p.sh., lidhja, pullat, zingjiri) dhe të di se çfarë rrobash të veshësh;
- ✓ Shkathtësitë e të ngrënit (p.sh., përdorimi i enëve, pecetave dhe një filxhan ose gotë, vendosja e një tryeze);
- ✓ Aftësi shëndetësore (p.sh., si të laheni apo pastrohen dhëmbët);
- ✓ Shkathtësi për kujdesin (p.sh., krehja e flokëve, pastrimi i thonjëve) (Texas Education Agency,2007).

- **Të mësojnë si të mësojnë**

Të mësuarit si të mësoni është po aq e rëndësishme sa të mësuarit vetë, në fakt të mësuarit varet nga përvetësimi i aftësive të të mësuarit:

- ✓ Aftësi vetë-ndihmuese për të promovuar një vetë-imazh të mirë dhe vetëvlersim të lartë;
- ✓ Njohuri për vetën, familjen dhe kulturën;
- ✓ Ndjenja e vlerës së vetvetës;
- ✓ Këmbëngulje, bashkëpunim, vetëkontroll dhe motivim për të mësuar;
- ✓ Rritja e besimit;
- ✓ Përgjegjësia për detyra të përshtatshme për moshën (Texas Education Agency,2007).

- **Gjuha dhe letërsia**

- Ekziston një theks i madh për të ndihmuar fëmijët parashkollorë të mësojnë aftësi shkrim-leximi. Për të zhvilluar aftësi gjuhësore dhe shkrim-leximi, parashkollorët duhet të punojnë në një shumëllojshmëri të aftësive:
 - ✓ Aftësi gjuhësore gojore;
 - ✓ Fjalor
 - ✓ Biseda me fëmijë të tjerë dhe të rritur
 - ✓ Aftësia në gjuhë
 - ✓ Shkathhtësia shkrim-leximi që lidhen me shkrimin dhe leximin;
 - ✓ Shkronjat e alfabetit;
 - ✓ Të kuptuarit e të dëgjuarit;
 - ✓ Motivimi për të lëxuar;
 - ✓ Mënyrat për të përdorur dhe vlerësuar librat (Texas Education Agency,2007).

- **Pavarësia**

Shkathhtësitë e pavarësisë i ndihmojnë fëmijët të kenë besimin që duhet për të arritur në aktivitetet e shkollës. Morrison (2020) pohon për:

- ✓ Bërja e gjërave për vete;
- ✓ Përgjegjësia për kalimin, mbledhjen dhe organizimin e materialeve;
- ✓ Mësojnë vetëdrejtimin (Morrison, 2020).

Një nga mënyrat më të mira për t'u siguruar që fëmija e kupton rëndësinë e shumëllojshmërisë së praktikuar vërtetë është duke i inkurajuar ata të bëjnë miq me fëmijë të ndryshëm se ata (Khan, 2020). Pra, edukimi parashkollor ndihmon shumë që fëmijët të shoqërohen me fëmijët e tjerë e që kjo është shumë domethënëse. Me saktësisht, edukimi parashkollor jo vetëm që ndihmon në zhvillimin e gjithanshëm të personalitetit të fëmijës, si në aspektin mendor, psiko-fizik, socio-emocional dhe të sjelljes, por edhe për impaktin social në fazat e mëvonshme të zhvillimit të fëmijës në shoqëri.

Ndikimi në zhvillimin e gatishmërisë së fëmijës për shkollë dhe të nxënë, ndikon në vijueshmërinë më të mirë të klasës së parë, duke e bërë shkollën më të dëshirueshme, fëmijët që ndjekin arsimin parashkollor, kanë gjasa më të vogla për të përsëritur klasën dhe

për të braktisur shkollën, arsimit parashkollor ndikon në arritshmërinë më të mirë të fëmijëve dhe përfundimin me sukses të shkollimit, investimi në arsimin parashkollor, zvogëlon shpenzimet e arsimit në faza të mëvonshme (KOMF, 2014).

Nga tërë kjo që u tha më lart për edukimin në përgjithsi, si dhe edukimin parashkollor, si shembull gjithmonë duhet të mirren shtetet e fuqishme, respektivisht, shtete që nxjerrin njerëz të aftë në nivel global. Si të tillë, në këtë rast do të mirret edukim në SHBA dhe të bëhet një krahasim me edukimin tonë kosovare. Të shihet se a ka dallime, çfare jane ato dallime, a mund dhe a dëshirojmë që të adaptojmë dhe modifikojmë diçka nga sistemi amerikan për të mirën e shoqërisë kosovare. Prandaj, edhe paraprakisht, në nëntitujt në vijim, do të diskutohet edhe për edukimin parashkollor në Kosovë.

1.3 Edukimi parashkollor në Kosovë

Edukimi parashkollor paraqet nivelin e parë të arsimit parauniversitar në Kosovë ku përfshihen fëmijët deri në moshën 6 vjeçare. Edukimi parashkollor në Kosovë, organizohet në institucionet parashkollore publike (çerdhet dhe kopshte) dhe institucionet parashkollore private me bazë në komunitet dhe niveli parafillor në kuadër të shkollave fillore. Edukimi

parashkollor është hallkë përbërëse e sistemit unik të edukimit dhe arsimit në Kosovë (Ligji mbi edukimin parashkollor, 2006).

Edhe pse edukimi parashkollor vlerësohet që të jetë baza që përcakton dhe fillon suksesi i nxënësve në shkollimin e metutjeshëm, prap se prapë ky nivel i edukimit nuk është trajtuar me prioritet dhe kujdesin që duhet në politikat arsimore. Kjo dëshmohet me sfidat që ballafaqohet edukimi parashkollor në Kosovë, si numri i vogël i kopshteve e që më të prekurit në mungesë të kopshteve, apo edhe parafillorve janë vendet rurale, mungesa e infrastrukturës në shkolla për mbajtjen e procesit mësimorë e shumë probleme të tjera.

Edukimi parashkollor në Kosovë organizohet në dy forma, edukimin parashkollor mosha 0 deri 5 vjeç dhe edukimin parafillor apo siç njihen klasat përgatitore mosha 5 deri 6 vjeç.

Edukimi parashkollor në Republikën e Kosovës aktualisht është i organizuar si në vijim: Në institucione publike (çerdhet që përfshijnë fëmijët e grup moshave 6 muaj deri 3 vjeç dhe kopshtet që përfshijnë fëmijët 3-6 vjeç; Në institucione private (kopshte për fëmijët 0-6 vjeç); Në klasat e para-filllore (fëmijët e moshës 5-6 vjeç, kryesisht të bashkëngjitura në shkollat e rregullta). Numri i edukatorëve/edukatoreve me kualifikime të duhura në nivelin e edukimit parashkollor 0-3 vjeç është i kufizuar (Ligji mbi edukimin parashkollor, 2006)

Agjencia e Statistikave të Kosovës bënë vazhdimisht raporte që paraqesin rezultate të rëndësishme dhe zyrtare për edukimin dhe sferat tjera, e që publikimi i fundit është Statistikat e Arsimit në Kosovë 2018-2019. Sipas rezultateve të dala nga ky publikim del se numri i fëmijëve në çerdhe dhe parashkollorë ishte 32,529, prej tyre në sektorin publik 26,595 fëmijë ose 81.8% ndërsa në sektorin privat 5,934 fëmijë ose 18.2% (Mekolli .et.al. 2019).

Siç e kemi cekur edhe më lart edukimi parashkollor në Kosovë ndahet në grupmoshat, parashkollor 0-5 vjeç dhe parafillor 5-6 vjeç.

Nga raportet e ndryshme siç janë raportet e publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, kemi parë që edukimi parashkollor nuk është ende i zhvilluar sidomos në vendet rurale, pasi që mungon infrastruktura, mbështetja institucionale e shumë probleme të tjera.

1.3.1 Qëllimet e edukimit parashkollor në Kosovë

Republika e Kosovës në kurrikulën e saj të edukimit parashkollor ka të paraqitura qëllimet e që ato janë:

- Zhvillimi tërësor i personalitetit të fëmijës, potencialit dhe shfaqjes maksimale të aftësive të tij.
- Zhvillimi dhe formësimi i individit të lirë, të përgjegjshëm, aktiv e ndërveprues.

- Zotërimi i aftësive dhe kompetencave komunikuese, shprehëse, logjike dhe vepruese e ndërvepruese.
- Zhvillimi dhe përvetësimi i aftësive njohëse, afektive-emocionale, shoqërore, morale dhe psikomotorë.
- Respektimi i barazisë së shanseve edukative për të gjithë fëmijët.
- Fëmija i lumtur, i aftë për t'u përballur me sfidat e jetës (MASHT, 2006).

Fëmijët në edukimin parafillor përgatiten për jetë, pra përgatiten si nga ana arsimore ashtu edhe nga ajo morale, emocionale, shoqërore, poashtu edhe që të zhvillohen më shumë.


Ndër qëllimet sipas ligjit mbi edukimin parashkollor në Kosovë janë edhe këto qëllime:

- Të inkurajohet afësia që të kuptohet dhe të pranohet vetvetja dhe të tjerët;
- Të inkurajohet aftësia për bashkëbisedime, të pranohen ndryshimet dhe të marrin pjesë në grupe;
- Të transferohet dituria në fusha të ndryshme të shkencës dhe jetës së përditshme;
- Të inkurajohet zhvillimi trupor dhe psikik;
- Të inkurajohet pavarësia e fëmijëve në higjienën personale dhe në kujdesin e shëndetit të tyre (Ligji mbi edukimin parashkollor, 2006).

Fëmijët në kopshte apo parafillor do të mësojnë shumë, ndër mësimet që do ti marrin do të jetë mësimi për të bashkëvepruar me moshatarët e tyre, luajtja me lojëra të ndryshme e gjëra të tjera që ndihmojnë në zhvillimin e tyre (Morrison, 2020).

Duke i parë edhe qëllimet të paraqitura në nëntitujt e mësipërm do të mund të shohim edhe rëndësinë e madhe që e ka edukimi parashkollor. Rëndësia qëndron edhe në faktin që fëmijët që nga fillimi i tyre në parashkollor përgaditen për arsimin e mëtutjeshëm e deri tek tregu i punës, gjë që paraqitet edhe në tabelën e mëposhtme (Tabela 1).

Tabela.1 Shkallët e edukimit dhe përgatitja për tregun e punës në Kosovë



Nga tabela e mësipërme e shohim që deri tek tregu i punës për një person ka shumë rrugëtime. Rrugëtimi fillon nga niveli parashkollor 0-5 pastaj parafillor dhe klasat 1-5 e më tutje deri tek Universiteti e tek tregu i punës. Për të qenë më të përgatitur për tregun e punës atëherë niveli parashkollor është po aq i rëndësishëm sa shkollimi fillor, universiteti e shkollimet e tjera.

Siç e kemi cekur edhe më lartë qëllimet na lë të kuptojmë që në bazë të qëllimeve e shohim edhe rëndësinë e madhe që e ka edukimi parashkollor dhe ai parafillor.


Kohë e fundit, diversiteti është bërë diçka e fjalës, është përdorur kaq shpesh edhe pse ka humbur shumë kuptim. Disa grupe e përdorin diversitetin në mënyra të cekëta, sikur të jenë vetëm disa të rëndësishme, kur e vërteta është diversiteti tepër domethënës duke çuar në një lidhje më të mirë, rritje dhe jetë për të gjithë.

1.4 Edukimi Parashkollor në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Sistemi arsimor amerikan është ndryshe nga ai në shumë vende të tjera. Qeveria federale amerikane kontribuon pothuajse 10% në buxhetin kombëtar të arsimit. Arsimi është kryesisht përgjegjësi e qeverisë shtetërore dhe lokale.

Më saktësisht sistemi arsimor i SHBA-ve është paraqitur në Tabelën 2, duke filluar nga niveli më i ulët deri te ai më i larti.

Tabela 2 .Shkallët e edukimit dhe përgatitja për tregun e punës në SHBA



Burimi: U.S. National Commission on Mathematics Instruction (USNC/MI)

Pjesa e poshtme e figurës tregon se arsimi publik mund të fillojë qysh në moshën 3 vjeçare pra në çerdhe, ndërsa fëmijët në çdo shtet të SHBA-ve janë të obliguar të fillojnë shkollën kur bëhen 5 ose 6 vjeç.

Shtetet dhe rrethet mund të konfigurjnë vitet e mesme në një shumëllojshmëri mënyrash dhe të siguroj një kombinim të lëndëve akademike, teknike dhe profesionale për studentët e mesëm.

Viti i fundit është klasa 12 e përfunduar në mënyrë tipike nga mosha 17 ose 18 vjeç.

Sistemi i arsimit të lartë ofron rrugë të shumta për studentët pas klasës së 12-të. Ata mund të shkojnë drejtpërdrejtë në një larmi karriere teknike dhe biznesi ose të shërbejnë si përgatitje për hyrjen në një program 4-vjeçar universitar. Studentët që kanë fituar një diplomë bachelor 4-vjeçare mund të hyjnë në shkollë profesionale (juridik, mjekësi, etj) ose një program masteri pastaj doktoraturë. Ata që kanë fituar një doktoraturë mund të kryejnë studime dhe hulumtime të mëtutjeshme duke ndjekur një pozicion postdoktoral.

Shkollat parashkollore dallojnë veten duke u përqendruar në mënyrë të barabartë në korrijen e zhvillimit shoqërorë të një fëmije, zhvillimin fizik, zhvillimin emocional dhe zhvillimin njohës. Ata zakonisht ndjekin një seri standardesh mësimore të krijuara nga organizata në formimin e kurrikulës dhe aktiviteteve/qëllimeve mësimore (Corsi-Bunker, 2019). Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës edukimi parashkollor përfshinë kopshtin e fëmijëve (çerdhet), shkollën e lojërave dhe shkollat e tjera edukative të fëmijëve.

Një nga iniciativat e para të edukimit të fëmijërisë së hershme në SHBA ishte programi Head Start, i cili u krijua në vitin 1965. Kjo nismë arsimore e financuar nga federate, e cila është e financuar nga Departamenti i Shëndetit dhe Shërbimeve Njerëzore, u siguron fëmijëve nga familjet me një socio-ekonomi më të ulët ose ata që kualifikohen nën një kategori specifike në rrezik me qasje të lirë në programet e edukimit të fëmijërisë së hershme (Williams, 2020).

Programet parashkollore zakonisht ofrojnë seanca dy ose tre orë në ditë, disa ditë në javë. Këto programme nuk përdoren kryesisht për kujdesin e fëmijëve, por përkundrazi u ofrojnë fëmijëve një mundësi në baza të pjesshme për të bashkëvepruar me fëmijët e tjerë dhe për t'u përgatitur për kopshtin e fëmijëve. Regjistrimi zakonisht është i kufizuar te fëmijët 3 deri në 5 vjeç.

Programet e arsimit parashkollor mbajnë një lidhje të ngushtë me shtëpinë dhe prindërit dhe kanë për qëllim t'i prezantojnë fëmijët me mjedisin shoqëror të shkollës. Aktivitetet shpesh zgjerohen për të përfshirë orientimet alfabetike dhe numerike, pra fëmijët që hyjnë në kopsht ose klasën e parë në moshën pesë ose gjashtë vjeç të cilët nuk kanë ndjekur arsimin parashkollor zakonisht janë në disavantazh.

Një përqindje shumë më e ulët e fëmijëve (rreth 60 përqind) ndjekin shkollën parashkollore në SHBA nëse bëjmë krahasimin me Japoninë dhe shumë vende evropiane (p.sh. Belgjika dhe Franca, ku janë 95 përqind). Në disa zona, shkollat parashkollore janë me mundësi të vogla dhe është e nevojshme të vendoset emrin në listen e pritjes sa më shpejt që të jetë e mundur. Disa prindër aplikojnë në Prill për vjeshtën e ardhshme (Shtator). Sidoqoftë, mund të aplikojnë gjatë gjithë vitit, vetëm ato programe që kanë hapësirë mund të pranojnë fëmijën menjëherë (Corsi-Bunker, 2019).

1.4.1 Qëllimet e edukimit parashkollor në SHBA

Disa nga mësimet që i marrin fëmijët në parashkollor:

- Fëmijët mësojnë shumë në parashkollor. Theksi është në zhvillimin konjitiv të fëmijës pasi të mësuarit është për shkak të ndërveprimit në një grup të madh.
- Ndërveprimi shoqëror është tipari i dytë më i rëndësishëm i arsimit parashkollor. Fëmijët mësojnë të bashkëveprojnë me fëmijët e moshës së tyre në një mjedis të mbikëqyrur.
- Ata mësojnë të identifikojnë gjërat e tyre si çanta e tyre, peceta dhe shishja e ujit. Këto janë thesaret e vërteta të fëmijëve të kësaj epoke.
- Fëmijët trajnohen për tualet.
- Menaxhimi i kohës është një veçori tjetër e rëndësishme e shkollës parashkollore (Kaushik and Marwaha, 2020).

Qëllimet e arsimit të hershëm në SHBA janë:

- Edukimi i hershëm përshkruan karakteristikat e cilësisë së kurrikulës dhe aktiviteteve të arsimit të hershëm me cilësi të larta.
- Kurrikula duhet të sigurojë një ekuilibër të lojës dhe aktiviteteve të strukturuar, duke përfshirë kërkime të iniciuara nga mësuesit dhe fëmijët.
- Bazur në nevojat e zhvillimit të një fëmije: aktivitete, materialet dhe oraret duhet të jenë të përshtatshme për moshën e një fëmije dhe të mbështesin të gjitha fushat e zhvillimit.
- Kurrikula duhet të pasqyrojë kërkimin aktual mbi zhvillimin e fëmijëve dhe duhet të përfshijë qëllime specifike të të nxënit për fëmijët.
- Departamenti i arsimit të SHBA-ve pranon që efektiviteti i një programi të fëmijërisë së hershme varet nga një numër faktorësh:
 - Një staf cilësor
 - Një mjedis i përshtatshëm
 - Program i qëndrueshëm
 - Përfshirja e prindërve
 - Praktikrat e duhura të grupimit

Duke bërë krahasimin mes Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës do të shohim se tek ne në Kosovë edukimi në çerdhe fillon nga mosha 0 deri në 5 vjeç ndërsa në SHBA fillon nga mosha 3 vjeç. Sa i përket shkollës fillore e kanë të ngjashëm klasën nga 1 deri në 5, pastaj pas klasës në 5 kanë dallim pasiqë ka shumëllojshmëri për të zgjedhur lëndët apo fushën që dëshirojnë të mësojnë. Vlen të ceket se edhe tek ne (në Kosovë) edhe në SHBA shkollimi i mesëm përfundon me klasën e 12-të.

Deri tek tregu i punës si në Kosovë ashtu edhe në SHBA janë mundësitë e vazhdimit të shkollimit në Universitet nivelin Bachelor, Master pastaj Doktoraturë e tutje, siq u panë edhe nga tabelat (Tabela 1 dhe Tabela 2).

2. METODOLOGJIA

Duke u nisur nga ajo çka u tha për edukimin parashkollor në SHBA dhe në Kosovë, ky punim synon që të analizoj edukimin parashkollor në Kosovë dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të nxjerr në pah statistikën për edukimin parashkollor në dy shtetet e lartcekura dhe të krahasojë qëllimet e edukimit parashkollor të të dy shteteve

Punimi si vend kryesor ka Kosovën ku do të shtjellojmë edukimin parashkollor të Kosovës e pastaj do të krahasohet edhe me edukimin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Bazuar në pyetjet hulumtuese të parashtruara:

1. A ka dallime të mëdha në mes të edukimit parashkollor në SHBA dhe në Kosovë?
2. A do ndryshonin sistemin parashkollor edukatorët kosovare, respektivisht a do e merrnin si model edukimin parashkollor të SHBA-ve?

Për realizimin e këtij hulumtimi është përdorur literatura profesionale , të dhëna primare, sekondare e publikime, dhe të dhëna nga Ministria e Arsimit. Më saktësisht, të dhënat janë marrë kryesisht nga institucionet e besueshme si në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, raporte të ndryshme vendore (MASHT, Ligji për edukimin parashkollor) dhe ndërkombëtare lidhur me edukimin si dhe raportet nga Departamentet e Edukimit në Amerikë, dhe të dhëna nga Herman et.al. (2013), dhe Samuels (2017).

2.1 Pjesëmarrësit:

Popullatë e këtij hulumtimi janë edukatorët kosovarë në komunën e Mitrovicës të cilët punojnë me fëmijët parashkollor.

Pjesëmarrës ishin dhjetë (10) edukatore nga parashkollori dhe në këtë hulumtim morën pjesë vetëm gjinia femrore. Si informatë shtesë e këtij punimi kur kemi të bëjmë me gjininë e edukatoreve, në Kosovë akoma nuk ka edukatorë (të gjinisë mashkullore që punojnë me fëmijët parashkollor).

2.2 Instrumentet:

Si instrument për mbledhjen e të dhënave të këtij hulumtimi është përdorur një pyetësor. Paraprakisht, ka pasur takim me këto edukatore, ku u është shpjeguar sistemi i edukimit në SHBA, me theks të veçantë sistemi parashkollor. Për ta pasur më të qartë sistemin e edukimit në SHBA, edukatoreve u është dhënë një shtojcë me fakte mbi edukimin në

SHBA dhe pastaj u është shpërndarë një pyetësor. Pyetësi është formuluar duke bërë përshtatjen e dy pyetësorve, një të Erasmus+ dhe një të Institutit Pedagogjik të Kosovës.

Respektimi i etikës së punës hulumtuese është pjesë e pandashme e të gjithë studimit, gjatë studimit është marrur parasysh respektimi i të gjitha kriterëve që kanë të bëjnë me ndershmërinë dhe mbrojtjen e të dhënave. Për plotsimin e pyetësorit i'u është siguruar pjesmarrje e vullnetshme edukatoreve dhe u respektua koha e tyre gjatë plotsimit të pyetësorit.

2.3 Mënyra e mbledhjes së të dhënave

Duke u nisur nga planifikimi i këtij hulumtimi, ka pasur takime me edukatorët e rrethit të Mitrovicës. Paraprakisht atyre u është dhënë lista (Shtojca 2) me të dhëna lidhur me edukimin në SHBA, me theks të veçantë në edukimin parashkollor. Pastaj u është dhënë pyetësi (anonim) për ta plotësuar (Shtojca1). Që kishte të bënte me edukimin parashkollor në Kosovë, dhe gjithashtu pyetësi përmbante pyetje të hapura ku edukatorët kishin mundësi të shpreheshin vetë. Edukatorët kanë ndihmuar me dhënien e përgjigjeve dhe nëpërmjet tyre kemi nxjerr rezultatet që na nevojiten për këtë punim, respektivisht që të mund të kemi të gjetura për pyetjet hulumtuese:

1. A ka dallime të mëdha në mes të edukimit parashkollor në SHBA dhe në Kosovë?
2. A do ndryshonin sistemin parashkollor edukatorët kosovare, respektivisht a do e merrnin si model edukimin parashkollor të SHBA-ve?


Sa i përket edukimit parashkollor në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ato i kam siguruar nga burimet e sigurta të internetit dhe disa të tjera nga librat dhe raporte të ndryshme.

Analizimi i të dhënave është bërë më programin SPSS (Statistical Package for the Social Sciences) dhe janë kryer analizat: analizat deskriptive, korrelacioni.

3 REZULTATET


Në këtë kapitull do të shpalojmë rezultatet që kanë dal nga anketa e realizuar me edukatorët në shkollat e Mitrovicës. Në bazë të përgjigjeve të dhëna nga to, kemi arritur që të nxjerrim grafika dhe tabela me rezultate të ndryshme e shumë të rëndësishme për hulumtimin tonë.

Grafika 1. Përvoja e pjesëmarrësve




Sipas të dhënave 60% e pjesëmarrësve kanë 1-5 vite në arsim dhe 40% kanë 11-20 vite.

Grafika 2. Institucioni ku punojnë




Nga pjesa e anketuar tregojnë se 100% punojnë në institucionin publik kurse 0% në institucionin privat.

Grafika 3. Niveli i trajnimeve




Sa i përket trajnimeve të ndjekura, edukatorët pjesëmarrës në këtë hulumtim qëndrojnë mjaft mirë. Të gjitha nga pjesëmarrëset kanë ndjekur trajnime për edukimin parashkollor.

Grafika 4. Shpërndarja e edukatoreve në bazë të institucionit.




Shpërndarja e të anketuarve sa i përket institucionit ka qenë 60% parashkollor dhe 40% në shkollë fillore.

Grafika 5. Mënyra e punës së fëmijëve




Fëmijët në institucionet që është bërë hulumtimi bëjnë grupore dhe të kombinuar, ndërsa vetëm individuale nuk bëjnë punë. Nga të anketuarit janë shprehur se 60% e fëmijëve punojnë në mënyrë individuale dhe grupore duke bërë kombinim dhe 40% e tyre punojnë në grup.

Grafika 6. Koha e kaluar në aktivitete




Koha që fëmijët kalojnë në aktivitetet kryesisht zgjatë 20 minuta. Me nga 30% kalojnë 15 dhe 30 minuta në aktivitete dhe 40% kalojnë 20 minuta në aktivitete.

Grafika 7. Qendra aktiviteteve në klasë




Në shumicën e shkollave ka qendra aktivitetesh në klasë.

Grafika 8. Aktivitetet e përdorura nga fëmijët




Nga anketa e bërë shohim që shumica e fëmijëve aktivitetin e tyre më të dashur e kanë vrapimin, pastaj e kanë lojën, lojën dramatike dhe në fund dëgjimin.

Grafika 9. Niveli i kërkesave të prindërve




Se sa është i rëndësishëm niveli parashkollor tregon edhe interesimi i madh i prindërve për regjistrimin e fëmijëve e që është një kërkesë e madhe. Niveli i kërkesave fillon me 10% të mëdha, 20% të vogla dhe 70% shumë të mëdha.

Grafika 10. Përdorimi i detyrave nga fëmijët




Fëmijët pëlqejnë detyra të ndryshme, por më së shumti kanë dëshirë dëgjimin e përrallave, lojën në natyrë, shikimin e fotove, loja puzzle etj.

Grafika 11. Përdorimi i kurrikulës




Nuk është paraqitur ndonjë problem tek edukatorët për të ndjekur kurrikulën.

Grafika 12. Organizimi i aktiviteteve në natyrë



Aktivitetet në natyrë janë shumë të dobishme për fëmijët andaj edhe edukatorët e praktikojnë këtë punë duke bërë organizime të ndryshme. Shumica janë përgjigjur 4-6 herë, pastaj shumë shpesh më shumë se 10 herë, dhe në fund shpesh 7-9 herë.

Grafika 13. Metodatat për mësimdhënie



Pyetjes se cilat nga metodatat/strukturatat e mëposhtme mësimore do ju shërbenë më mirë gjatë mësimdhënies, edukatorët shumica janë përgjigjur aktivitetetë ndryshme për fëmijët të cilat mund t'i ndërlihdhënit gjatë mësimet, pastaj propozim aktivitetesh për të kompletuar procesin e mësimdhënies apo klasën dhe grupe aktivitetesh apo leksionesh/klasash për çdo fushë (psh., pyjet, fushat, etj.)

Në pyetësor kemi pasur edhe dy pyetje të hapura e që janë në shtojcën nr. 1, (pyetja 19: Çka do të ndryshonit në nivelin parashkollor, po të kishit mundësi? Pse?) dhe (pyetja 20: Çka nuk do të ndryshonit sepse mendoni se është e përshtatshme për nivelin parashkollor në Kosovë? Pse?).

Në pyetjen e 19-të se çka do të ndryshonin në nivelin parashkollor po të kishin mundësi ato janë përgjigjur për ndryshimet që do t'i bënin .Ndër përgjigjet më të shpeshta kanë qenë hapësirat në kopshte në mënyrë që të realizojnë aktivitetet, të pajisen me më shumë lodra, materiale për realizimin e aktiviteteteve, mospërdorimi i librave sepse nuk është e përshtatshme për moshën e fëmijëve, disa shprehin dëshirën të ndërtojnë më shumë çerdhe në qytet, të kenë më shumë trajnime për edukatorët, fëmijët të vizitojnë më shumë institucione të ndryshme duke siguruar transport nga shkolla.

Në pyetjen se çka nuk do të ndryshonin sepse mendojnë se janë të përshtatshme për nivelin parashkollor në Kosovë, 3 nga 10 janë përgjigjur se nuk do ta ndryshonin orarin në parashkollor, poashtu 3 nga 10 që kishin edhe numër të vogël fëmijësh në grup nuk do të ndryshonin numrin e fëmijëve

Sa i përket pyetjes së parë hulumtuese “A ka dallime të mëdha në mes të edukimit parashkollor në SHBA dhe në Kosovë?”, në bazë të rezultateve të fituara nga pyetëtorët dhe nga të dhënat e siguruar për sistemin e edukimit parashkollor në SHBA shohim se kemi disa dallime,(gjithmone duke u bazuar të përgjigjet e edukatoreve)

Tabela 3a. Edukimi parashkollor në Kosovë

Mosha e fëmijëve në klasën/kopshtin tuaj?	N	%	Mean	Std. Deviation
3-4 vjece	5	50.0	1.90	0.943
4-5 vjece	1	10.0		
5-6 vjece	4	40.00		
Numri i fëmijëve në klasën tuaj?	N	%	Mean	Std. Deviation
10-15	4	40.0%	2.00	1.154
20-25	4	40.0%		
30+	2	20.0%		
Sa edukatore punojnë me një grup të fëmijëve?	N	%	Mean	Std. Deviation
1 edukatore	2	20.0%	2.40	1.074
2 edukatore	4	40.0%		
1 edukatore dhe 1 motër edukatore	4	40.0%		
Sa orë në ditë punoni me fëmijët?	N	%	Mean	Std. Deviation
3 orë	2	20.0	2.40	1.074
4 orë	4	40.0		
6 orë	2	20.0		
8 orë	2	20.0		

Tabela 3b. Edukimi parashkollor në SHBA

Edukimi parashkollor në SHBA		N
Mosha e fëmijëve në klasë/kopësht	3-2 Vjeç	
Numri i fëmijëve në grupe	20 Fëmijë	
Numri i edukatoreve në grupe	3 Edukatore	
Orari i punës	6 orë	

Sipas të dhënave nga anketuesit 50% (5 pjesëmarrës) i kanë fëmijët në moshën 3-4 vjeç, 40% (4 pjesëmarrës) i kanë moshën 5-6 vjeç dhe 10% (1 pjesëmarrës) i kanë të moshës 4-5 vjeç ndërsa në SHBA sipas të dhënave kemi moshën 3-5 vjeçe (Herman J. et.al. 2013).

Numri i fëmijëve në klasë është mjaft e madhe, 40% kanë 10-15 fëmijë në grup, 40% të tjerë kanë 20-25 fëmijë në grup dhe 20% kanë mbi 30 fëmijë në grup që është një numër i madh dhe problematik si për edukatoren ashtu edhe për fëmijët sipas të dhënave që kemi

mblodhur për SHBA-në numri i fëmijëve në parashkollor është rreth 12-20 fëmijë në një klasë apo kopësht, 11-25 fëmijë maksimum (Samuels, 2017).

Në shumicën e shkollave punojnë nga 2 edukatore me një grup, 60% e tyre punojnë nga dy edukatore me një grup dhe 40% punojnë nga 1 edukatore në një grup, ndërsa duke u bazuar në të dhënat e mblodhura, në SHBA vetëm një edukatore mund të punojë me 15 fëmijë, por nëse numri i fëmijëve është 12-20 në parashkollorë atëherë duhet të punojnë 2 edukatore.

Orari ditor që punojnë me fëmijët ka ndryshime, ku 40% e të anketuarëve punojnë nga 4 orë në ditë, dhe me nga 20% janë që punojnë 3,6 dhe 8 orë në ditë, por sa i përket orarit në Amerikë në parashkollorë edukatorët punojnë nga 6 orë në ditë duke filluar nga ora 09:00 e mëngjesit deri në orën 15:00 mesdite, ndërsa sa i përket qendrave të kujdesit për fëmijë në qendër punojnë nga ora 09:17 pasdite ose nga ora 07:00 deri në orën 18:00. Këto qendra kujdesen për fëmijët 1-2 vjeç dhe 3-5 vjeç (Kameraman, et.al .2007).

Tabela 4a. Aktivitetet dhe detyrat e fëmijëve në Kosovë

Cilen nga keto aktivitete e perdorin me shpesh femijet	N	%
Vrapim, kërcim, aktivitete motorike	6	60.0
Lojë të lire	2	20.0
Dëgjimi i tregimeve të lexuar me zë të lartë	1	10.0
Lojë dramatike, arte dhe muzik.	1	10.0
Cilat nga detyrat e meposhtme i perdorin femijet me se shpeshti	N	%
Të mësuarit e shkronjave.	3	30.0%
Të mësuarit e numrave.	0	00.0%
Dëgjimin e përrallave	9	90.0%
Loja në natyrë	8	80.0%
Shikimi i fotove në libra.	8	80.0%
Krijimi i historive me figura.	5	50.0%
Plotësimi i librave me figura	6	60.0%
Loja teatrale	1	10.0%
Loja puzzle	7	70.0%
Lojrat në tavolinë	4	40.0%
A ju paraqet problem te ndiqni kurrikulen?	N	%
PO	0	00.0
JO	10	100.0

Tabela 4b. Mësimet e fëmijëve në SHBA

Mësimet në SHBA
Gjuha dhe shkrimi
Studime sociale
Artet
Matematika
Mendimi shkencor

Këto aktivitete të paraqitura në tabelë që fëmijët në Kosovë i praktikojnë janë pak më ndryshe se në Amerikë ,ku atje aktivitetet që më së shumti i praktikojnë janë :koha e rrethit,këngës ,kalendarit, koha e zanatit ,udhëtimet nëper terenë të dizajnuara për të përmisuar një mësim ,si udhëtime në zyra postare ose vizita tek oficeri polic ,vizita tek dentisti vizita nëpër dyqane ku fëmijët përmes kësaj njihen me ushqimet e shëndetshme etj.

Katër nga dhjetë edukatore janë përgjigjur se pikërisht në Kosovë tek institucionet parashkollore fëmijët kanë shumë nevojë që të praktikojnë aktivitetet si:koha e zanatit,udhëtimet nëpër vende të ndryshme. Poashtu, 4 edukatore kanë treguar nëpërmjet pyetjes së hapur se çka do të ndryshonin, kanë dëshiruar që të shtojnë vizitat e ndryshme me fëmijët, të financuara nga shkolla, çerdhet, qendrat ku punojnë.Sipas edukatoreve, fëmijët pëlqejnë detyra të ndryshme, por më së shumti kanë dëshirë dëgjimin e përrallave, lojën në natyrë, shikimin e fotove, loja puzzle etj.

Sa i përket detyrave apo fushave kryesore që punojnë fëmijët në institucionin parashkollorë në Amerikë janë: Letra, Numrat,Format,Ngjyrat,Prerje,Ngjyrosje,Shkrimi i shkronjave,dhe të numrave,rënditja e objekteve ,vizatimi,ngjitje,aktivitete fizike,kërcim vrapim etj (Williams, 2020). Poashtu, edhe në Kosovë, edukatoret pohojnë se mësojnë rreth shkronjave, alfabetit, numrave, muzikës, vizatimeve.

Pra, duke u bazuar në përgjigjet e edukatoreve të dhëna më lart, nënkuptohen se pyetjes së dytë hulumtuese:” A do ndryshonin sistemin parashkollor edukatoret kosovarre,respektivisht a do e merrnin si model edukimin parashkollor të SHBA-ve?”, shohim se edukatoret kosovare dëshirojnë që t’i marrin disa gjëra nga sistemi parashkollor i SHBA-ve, duke filluar nga numri i fëmijëve në grupe, numri i edukatoreve për fëmijë, si dhe hapësirat punuese që i kanë.

4.DISKUTIME

Pas shqyrtimit të literatures dhe të gjeturave të këtij punimi mund të diskutojmë rreth gjetjeve tona duke i vërtetuar pyetjet hulumtuese ose duke i hedhur poshtë ato.

Nga pytja e parë hulumtuese “A ka dallime të mëdha në mes të edukimit parashkollor në SHBA dhe në Kosovë?” rezultatet na tregojnë se në Kosovë moshë ku fëmijët mund të dërgohen në parashkollorë është 0-5 vjeç, orari i qëndrimit të fëmijëve në institucionin parashkollor është 8 orë, numri i fëmijëve në kopsht është 20-25 me nga dy edukatore kurse në Amerikë fëmijët mund të dërgohen në parashkollorë në moshën 3-5 vjeç ku qëndrojnë aty 6 orë, kryesisht numri i fëmijëve brenda kopshtit është 9 me nga 1 edukatore. Vlen të ceket se në Kosovë kemi ende probleme me hapësirat punuese, mjetet e punës, numri i madh i fëmijëve brenda grupit dhe shumë probleme tjera, andaj edhe ka dallime të mëdha në mes edukimit parashkollor në SHBA dhe në Kosovë.

Duke u bazuar në të dhënat e një publikimi nga Universiteti i Minnesotas (Corsi-Bunker, 2019). për sistemin e edukimit në SHBA theksohet se atje edukimi parashkollor përfshinë kopshtin e fëmijëve (çerdhet), shkollën e lojërave dhe shkollat e tjera edukative të fëmijëve. Programet parashkollore zakonisht ofrojnë seanca dy ose tre orë në ditë, disa ditë në javë. Këto programme nuk përdoren kryesisht për kujdesin e fëmijëve, por përkundrazi u ofrojnë fëmijëve një mundësi në baza të pjesshme për të bashkëvepruar me fëmijët e tjerë dhe për t'u përgatitur për kopshtin e fëmijëve. Regjistrimi zakonisht është i kufizuar të fëmijët 3 deri në 5 vjeç. Orari i qëndrimit është zakonisht 6 orë nga ora 9:00 – 15:00 pasdite. Fëmijët përpos lojërave që bëjnë ata edhe mësojnë rreth gjuhës, shkrimit, studimeve sociale, arteve, matematikës. Sa i përket numrit të fëmijëve dhe edukatoreve në institucionet parashkollore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, janë 9 fëmijë me një edukatore.

Pyetja e dytë hulumtuese ishte ”A do ndryshonin sistemin parashkollor edukatoren kosovare, respektivisht a do e merrnin si model edukimin parashkollor të SHBA-ve”. Të gjeturat nga kjo pyetje na tregojnë se edukatoren kosovare do merrnin shumë gjëra nga sistemi parashkollor në SHBA, duke filluar nga numri i fëmijëve në grupe, numri i edukatoreve për fëmijë, si dhe hapësirat punuese që i kanë.

Duhet ndihmuar edukatoren duke plotësuar kërkesat e tyre, pasi që nëpërmjet atyre kërkesave fëmijët do të mund që të zhvilloheshin më shumë. Paisjet, hapsirat punuese, vizitat e ndryshme, do të ju ndihmonte shumë fëmijëve për të mësuar shumë gjëra të reja. Nëpërmjet një vizite në ndonjë vend qoftë historik, artistik apo ndonjë vend tjetër, fëmijët do të mund që të njiheshin më shumë me botën reale dhe të përditshme, dhe do largoheshin nga bota virtuale.

Duke u nisur nga Williams (2020), Departamenti i arsimit të SHBA-ve pranon që efektiviteti i një programi të parashkollorve varet nga një numër faktorësh, si një staf cilësor, një mjedis i përshtatshëm, programim i qëndrueshëm, përfshirja e prindërve, praktikat

e duhura të grupimit, si dhe duke i krahasuar me të gjeturat tona, mund të shohim se nga rezultatet e punimit, edukatorët kërkojnë më shumë trajnime sa i përket edukimit parashkollor e që do të ju ndihmonte të ushtronin aktivitetin e tyre. Kërkesa tjera të tyre ishin edhe hapësirat punuese, grupet apo numri i fëmijëve e që të gjitha këto sipas departamentit të arsimit të SHBA-ve ndikojnë në efektivitetin e programit parashkollorë.

Grupet e vogla janë një metodë shumë efektive për të përmbushur nevojat dhe aftësitë e secilit fëmijë në klasë. Ato janë të preferueshme si për fëmijët ashtu edhe për edukatorët sepse lejon që të dallojnë dhe mësojnë më shumë fëmijët (Levin, V. 2019), që perkon me kërkesen e edukatoreve-pjesëmarrësve në këtë hulumtim.

Një faktorë tjetër i rëndësishëm që shihet më lartë është edhe përfshirja e prindërve. Sipas edukatoreve kosovare nuk mungon përfshirja e prindërve, mirëpo nuk duhet që të jetë edhe në një nivel të lartë që të mund të pengonte punën e tyre. Qëllimi i përfshirjes së prindërve është që të arrihet një mësim më cilësor. Informimi i prindërve sa i përket gjithë mësimëve dhe aktiviteteve që do bëhen, do kishte efekt pozitiv tek fëmijët. Ata do krijonin një raport dhe lidhje shumë të rëndësishme që nga fëmijëria në mes të prindërve dhe shkollës.

Nga ajo që u tha më lart, u pa që në Kosovë ende ka probleme sa i përket infrastrukturës shkollore e që është problem mjaft i madh. Ndër problemet e ndryshme por edhe të rëndësishme ishin hapësirat punuese, mjetet e punës dhe numri i madh i fëmijëve në raport me numrin e edukatoreve. Numri i fëmijëve në raport me edukatorët është shqetësues për faktin që sa më i madh të jetë numri i fëmijëve në një grup, do ishte më problem si për edukatorët ashtu edhe për fëmijët që të mund të kuptojnë mësimet. Në grupe ku ka fëmijë më pak për edukatorë, fëmijët e kanë më të lehtë pasiqë edukatorët mund të i'u kushtojnë kohë gjithësecilit fëmijë, ndërsa në grupe të mëdha është më vështirë.

5.KONKLUDIME DHE REKOMANDIME

Rëndësia e arsimit është mjaft e madhe e sidomos rëndësia e edukimit parashkollor, pasi që çdo njeri fillon të formohet profesionalisht që nga edukimi i hershëm siç e quajmë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pra nga edukimi parashkollor.

Nevoja e madhe për reforma dhe mjetet e kufizuara kanë bërë të vështirë që të mund të arrihen rezultatet e dëshiruara.

Sa i përket arsimit në Kosovë gjendja ka filluar që të përmirësohet pasi që më herët ka qenë tejte e vështirë. Duke u bazuar në të gjeturat e punimit mund të konkludojmë që është përmirësuar dukshëm infrastruktura nëpër shkolla, është bërë avansim i madh sa i përket trajnimit të edukatorëve dhe mësimdhënësve.

Prapë se prapë edhe pas reformimeve të mëdha që janë bërë në arsimin në Kosovë, ende ka nevojë për reformime të mëdha.

Edukimi parashkollor në Kosovë kohëve të fundit ka marr hov të madhë andaj edhe është duke u zhvilluar shumë, veçse duhet kujdes, vëmendje dhe përkushtim më të madh të të gjithë institucioneve. Kosova si një vend i vogël në krahasim me SHBA-të ka bërë hapa të rëndësishëm për zhvillimin e edukimit parashkollor, por do mund që të adaptonte disa gjëra nga sistemi arsimor në SHBA.

Në bazë të anketave të përfunduara dhe hulumtimit tonë, kemi arritur në përfundim që është e nevojshme të mund të merrnin disa gjëra nga sistemi i arsimit parashkollor në SHBA, si p.sh., numrin e fëmijëve në grup, pasi që në Kosovë ka grupe me shumë fëmijë dhe është mjaft problem si për edukatorët ashtu edhe për fëmijët për mbajtjen e mësimit. Numri i vogël i fëmijëve dhe rritja e numrit të edukatoreve automatikisht do të nënkuptonte që një edukatore do të mund të kishte mundësi të organizonte më lehtë mësimin dhe të punonte më shumë me secilin fëmijë.

Në bazë të të gjeturave lidhur me pytjen e 19 hulumtuese se a ka dallime të mëdha në mes të edukimit parashkollor në SHBA dhe në Kosovë, në bazë të rezultateve mund të themi që kemi dallime ndërmjet dy sistemeve. Ka gjëra siç janë oraret, modeli i mësimit, aktivitetet që janë të njëjta si në Amerikë ashtu edhe në Kosovë. Dallimet mund t'i shohim në shumë aspekte dhe fusha, siç janë mjetet e punës, hapsirat punuese, numri i fëmijëve dhe edukatoreve e që janë mjaft të rëndësishme.

Gjithashtu ,edhe duke u bazuar në të gjeturat lidhur me pytjen e 20 hulumtuese lidhur me mendimet e edukatoreve se a do ndryshonin sistemin parashkollor edukatorët kosovare, respektivisht a do e merrnin si model edukimin parashkollor të SHBA-ve, në bazë të përgjigjeve të edukatoreve mund të konkludojmë se sistemi parashkollor sa i përket kurrikulave janë thuajse të njëjta. Ajo se çka do merrnin si model nga edukimi parashkollor në SHBA janë ato që u cekën edhe më lartë, aty ku i kemi dallimet e mëdha.

Duke e parë rëndësinë e edukimit parashkollor dhe përkushtimin e shteteve të tjera, ne rastin ton atë të SHBAve lidhur me edukimin, rekomandimet tona për institucionet si MASHT, Qeveria e Kosovës dhe të tjera do të ishte që të mirret model SHBA (me ato mundësi që ka) dhe të ndaheshin më shumë fonde nga buxheti i shtetit për edukimin

parashkollor, të hapeshin më shumë çerdhe me kushte dhe hapësira të mëdha, të kete trajnime të edukatoreve, dhe sigurimi i mjeteve të punës.

Si perfundim mund të themi se rëndësia e madhe të trajnimeve të edukatoreve dhe kushteve të punës që kanë në punën e tyre është shumë e rëndësishme, pasi që puna e tyre lidhet direkt me fëmijët parandaj edhe duhet të ofrohen trajnime për edukatore dhe të ofrohen kushte me mjetet e punës për të qenë sa më kualitativ në punën e tyre. Përndryshe, nuk do të mund që të arrijmë të krijojme një shoqëri të mirfillte që perkon me kërkesat dhe nevojat, po gjithashtu edhe me dëshirat e shekullit të 21te, duke filluar nga individi, pastaj nga klasa, shkolla, shoqëria dhe vendi në tërësi nëse nuk ofrohen kushtet adekuate për punë.

6. REFERENCAT

- Arsimimi –detyrim i një shteti vizionar (2014), Prishtinë, KOMF(Koalicion i OJQ-ve për mbrojtjen e fëmijëve).*
- Corsi-Bunker, A. (2019). *Early Childhood education*. International Student & Scholar Services, University of Minnesota.
- European Commission (2020). *Teaching and Learning in pre-primary education*. Eurydice.
- Gjelaj, M., Rraci, E., Bajrami, K. (2018).*Edukimi parashkollorë në Kosovë. KEEN-Rrjeti i Kosovës për arsim dhe punësim.*
- Heckman, J. (2010). *Early Childhood Education Has a High Rate of Return, The economics of human potential.*
- Herman, J., Post, S., O’Halloran, S. (2013). *The United States is far behind other countries on Pre-K. Center for American Progress.*
- Jones, J. (2010). *Early learning standards and curriculum in the United States*. Paris,France.Senior Advisor to the Secretary for early learning U.S.Department of education.
- Kammerman, Sh., Gatenio-Gabel, Sh. (2007). *Early Childhood Education and Care in the United States: An Overview of the Current Policy Picture, ICEP Vol. 1, Nr. 23-24, Korea Institute of Child Care and Education.*
- Karp, N. (2003). *Early Childhood Education and Care in the USA , Brookes Publishing C., Inc, U.S. Department of Education, OERI.*
- Kaushik, P. and Marwah R (2020). *Importance of Preschool Education*. New Delhi, The Progressive Teacher.
- Khan, O. (2020). *The importance of your child meeting diverse friends. Noblesville, ABCs and 123s Learning Centers.*
- Kurrikula e edukimit parashkollor në Kosovë (3-6 vjeç) (2015), Prishtinë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.*
- Levin, V. (2019). *Small group activies for preschool, El Dorado USA, Pre-K Pages.*
- Ligji nr. 02/L-52 mbi edukimin parashkollor në Kosovë (2006), Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*
- Lipoff, S. (2011). *History of early childhood education*. Livingston, Funderstanding L.L.C.

Mekolli, E., Bruqi, Sh., Lahi, H., Kryeziu, A., Rexhepi, N., Uka, A., Bullatovci, Sh., Cakolli, A. (2020). *Statistikat e arsimit në Kosovë 2019/20, Prishtinë, Agjencia e Statistikave të Kosovës*

Morrison, G.S (2020). *Appropriate Preschool Goals*. Education.com LLC

Samuels, Ch. (2017). *Preschool class size – within reason – doesn’t matter, study finds*. *Education Week*

Sverdlov, A., Goldhirsch, O., Barocas, E., Ron, E., Budnick, G., Biger, H. and Shmueli, T. (2010). *Preschool educational practice , Israel, Gaaf Advertising, Ministry of Education*.

TEA, *Goals of preschool education (2007)*, Austin, Texas, Texas Education Agency.

Williams. B. (2020). *What is early childhood education*. *PreschoolTeacher.org*

SHTOJCA 1

Pyetësor për mësuesit

Unë jam Eroida Istrefi studente e vitit të katërt në Fakultetin e Edukimit. Për të punuar punimin e diplomës, kam përcaktuar të hulumtoj rreth krahasimit në mes dy sistemeve të edukimit parashkollor: Kosovar dhe amerikan – Rast studimi në rrethin e Mitrovicës. Me mirësjellje ju lus të plotësoni me sinqeritet pyetësorin. Të dhënat tuaja do të jenë konfidenciale dhe nuk do të përdoren për asnjë qëllim tjetër.

Ju falenderojmë për kontributin tuaj.

1. Përvoja juaj në arsim?

- a) 1-5 vite
- a) 6-10 vite
- b) 11-20 vite
- c) Më shumë se 20 vite

2. Institucioni në të cilin punoni është?

- a) Privat
- b) Publik

3. A keni ndjekur trajnime për edukimin parashkollor?

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk dua të përgjigjem

4. Moshë e fëmijëve në klasën/kopshtin tuaj?

- a) 3-4 vjeqe
- b) 4-5 vjeqe
- c) 5-6 vjeqe

5. Numri i fëmijëve në klasën tuaj?

- a) 10-15

- b) 20-25
- c) 26-30
- d) 30+

6. Jeni mësuese/edukatore në shkollë fillore apo parashkollor/kopsht?

- a) Parashkollor/kopësht
- b) Shkollë fillore
- c) Tjetër

7) Sa edukatore punojnë me një grup të fëmijëve?

- a) 1 edukatore
- b) 2 edukatore
- c) 1 edukatore dhe 1 motër edukatore

8. Sa orë në ditë punoni me fëmijët?

- a) 1 orë e gjysmë
- b) 3 orë
- c) 8 orë

9. A punojnë fëmijët në mënyrë individuale apo në grupe?

- a) Individuale
- b) Grupe

10. Sa minuta në ditë kalojnë fëmijët në aktivitet?

- a) 15 min
- b) 20 min
- c) 30 min

11. Cilën nga këto aktivitete e përdorin më shpesh fëmijët ?

- a) Vrapim, kërcim, aktivitete motorike
- b) lojë të lirë

- c) Dëgjimi i tregimeve të lexuar me zë të lartë
- d) Lojë dramatike, arte dhe muzik.

12. A ka qendra aktivitetesh në klasë?

- a) Po
- b) Jo.

13. Kërkesat e prindërve për regjistrimin e fëmijëve në institucion janë:

- a) të vogla
- b) të mëdha
- c) shumë të mëdha

14. Cilat nga detyrat e mëposhtme i përdorin fëmijët më së shpeshti?

- a) Të mësuarit e shkronjave.
- b) Të mësuarit e numrave.
- c) Dëgjimin e përrallave
- d) Loja në natyrë
- e) Shikimi i fotove në libra.
- f) Krijimi i historive me figura.
- g) Plotësimi i librave me figura
- h) Loja teatrale
- i) Loja puzzle
- j) Lojrat në tavolinë

15. Sa shpesh organizoni aktivitete jashtë në natyrë?

- a) Shumë shpesh (10 herë ose më shumë aktivitete në natyrë)
- b) Shpesh (7-9 herë)
- c) Ndonjëherë (4-6 herë)

d) Asnjëherë

e) Tjetër

16. Cilat nga metodat/strukturat e mëposhtëme mësimore do t'ju shërbente më mirë gjatë mësimdhënies?

a) Aktivitete të ndryshme për fëmijët të cilat mund t'i ndërlihdhënit gjatë mësimit

b) Propozim aktivitetesh për të kompletuar prcesin e mësmimdhënies apo klasën

c) Grupe aktivitetesh apo leksionesh/klasash për çdo stinë

d) Grupe aktivitetesh apo leksionesh/klasash për çdo fushë (psh. pyjet, fushat, ligatina, etj.)

17. A ju paraqet problem të ndiqni kurrikulën? A ju lejohet të keni autonomi në klasë kur keni të bëni me kurrikulën?

Po

Jo

Nëse po, çfarë është problemi për të ndjekur kurrikulën?

18. Cilat janë vështirësitë që ju si edukatore më së shumti përballeni?

- a) Numri i madh i fëmijëve;
- b) Liria e tepërt e prindërve në menaxhimin e klasës;
- c) Staf i menaxherial;
- d) Vet hapsira e klasës është problematike;
- e) Mungesë edukatoresh.

19. Çka do të ndryshonit në nivelin parashkollor, po të kishit mundësi? Pse?

20. Çka nuk do të ndryshonit sepse mendoni se është e përshtatshme për nivelin parashkollor në Kosovë? Pse?

Shtojca 2

- **Mosha kur fillon edukimi parashkollor në SHBA**

Për shumicën e fëmijëve hyrja në programet e shkollimit është kur fëmijët janë midis moshës 3 – 5 vjeç, pasi që do t'i ndihmonte fëmijët për shkollimin pasues.

- **Orari i qëndrimit në parashkollor**

Niveli parashkollorë përfshinë gamën e programeve të ofruara nën kujdesin publik dhe privat të arsimit dhe kryesisht janë gjysmë dite ose mbulojnë ditën normale të shkollës (zakonisht rreth 6 orë , 9:00 – 3:00 pasdite).

- **Aktivitetet**

Koha e rrethit, këngës, kalendarit, koha e zanatit. Udhëtime në teren të dizajnuara për të përmirësuar një mësim, si udhëtime në zyra postare, vizita në dyqane ushqimore për të mësuar për ushqimet e shëndetshme, tek oficeri në polici, tek dentisti, etj. Koha e aktiviteteve është 3 orë gjatë gjithë ditës, por me pushime dhe aktivitete të ndryshme.

- **Orari gjithëditor**

Mbërritja dhe mëngjesi 9:00

Hapet në ora 9:00, fëmijët luajnë dhe hajjnë mëngjes.

Qendra e veprimtarisë 9:25 – 10:45

Fëmijët luajnë me blloqe, eksperimentojnë të bëjnë llogaritje në matematikë, veprimtari shkencore

Morning Snack 10:45 – 11:00

Meze të lehtë të shëndetshme si karrota, djath, etj.

Loja në natyrë 11:00-11:50

Koha për të dalë jashtë në natyrë e që është pjesë e aktivitetit të përditshëm.

Dreka 11:50-12:30

Koha për të larë duart, fëmijët ndihmojnë në shtrimin e tryezave he për tu përgatitur për të ngrënë drekë.

Koha e pushimit 12:30 – 14:15

Nga ora 12:30 – 12:45 fëmijët bëjnë pastrimin e duarve dhe bëhen gati për pushim, ndërsa pushimi fillon nga 12:45 deri më 14:15. Ata të cilët nuk flejnë apo edhe nuk pushojnë mund të vendosin që të shikojnë libra dhe figura të ndryshme.

Qendra e veprimtarisë 14:15-15:00

Fëmijët bëjnë veprimtari lidhur me temën e udhëhequr nga edukatorja.

Koha në grup 15:00 – 15:15

Mblidhen si grup dhe bisedojnë rreth ngjarjeve të ditës, mund të përfshijnë edhe leximi me zë ose këndimin.

Snack Pasdite 15:15 – 15:30

Meze e lehtë.

Loja në natyrë dhe përgatitja për të shkuar në shtëpi 15:30 – 16:15.

- **Mësimet**

Si pjesë e kurrikulës parashkollore, fëmijët do të mësojnë të njohin dhe emërtojnë shkronjat e alfabetit, të identifikojnë emrat e tyre dhe të zhvillojnë lidhje midis shkronjave.

1) Gjuha dhe shkrim leximi

Fëmijët e nivelit parashkollor në SHBA zhvillojnë aftësitë e tyre gjuhësore shprehëse dhe pranuese përmes ndërveprimeve të tyre të përditshme me të rriturit dhe fëmijët e tjerë. Kjo përfshinë praktikimin e marrjes me kthesë të bisedave, përfshirjen në lojën me kukulla, mësimin e këngëve, lojërave me gishta dhe dëgjimin e tregimeve.

2) Studime sociale

Fëmijët në këto shkolla zhvillojnë aftësi të shëndetshme jetese të tilla si larja e duarve para ngrënies dhe fshirja e hundës me një façoletë. Fëmijët inkurajohen të luajnë mirë me fëmijët e tjerë, duke përfshirë aftësinë për të zgjidhur mosmarrveshjet e thjeshta, për të zgjidhur problemet, etj.

3) Artet

Fëmijëve u jepen mundësi të eksplorojnë dhe zbulojnë konceptet muzikore duke dëgjuar, vallëzuar në muzikë dhe duke eksploruar modelet e ritmit të një larmie instrumentesh muzikore. Ata zhvillojnë një larmi aftësish lëvizjesh si: hedhja, kapja, ecja, majat e këmbëve, përkulja, shtrirja dhe përdredhja.

4) Matematika

Fëmijët mbështeten në hetimet e tyre për t'u njohur me gjuhën matematikore, duke ndërtuar fjalorin e tyre, p.sh. "më të madh se", "më të vogël". Zgjerohen shkathhtësita e numrimit duke luajtur lojën me numrimin e gjërave të ndryshme.

5)Mendimi shkencor

Fëmijët zhvillojnë një ndjenjë kërkimi duke mbledhur informacione nga një larmi burimesh si libra, postera dhe sende nga shtëpia. Ata kanë një mundësi për të eksploruar dhe eksperimentuar me një larmi materialesh, të tilla si rëra, uji dhe inkurajohen të përdorin të menduarit reflektues duke pyetur pse ndodhin gjërat dhe çfarë mësojmë nga këto përvoja.

- **Numri i edukatorëve**

Në mostrën e disa studimeve raportet fëmijë – edukatorë variojnë nga 5 në 1 deri në 15 në 1, me një mesatare prej rreth 9 në 1.

- **Numri i fëmijëve në grupe**

Grupet e vogla janë një metodë shumë efektive udhëzuese që ju lejon të synoni udhëzimet tuaja për të përmbushur nevojat dhe aftësitë e secilit fëmijë në klasë. Në rastin ideal grupet e vogla mund të përfshijnë tre deri në gjashtë fëmijë për çdo grup. Ata mund t'i ndajmë në disa grupe të vogla. Numri i grupeve do të varet nga fëmijët në klasë, p.sh., nëse kemi 20 fëmijë mund të kemi 4 grupe nga 5 fëmijë, ose dy grupe me nga 4 fëmijë dhe dy grupe me 6. Nuk është e rëndësishme sa grupe janë, por se si janë ndarë grupet. Koha e grupeve duhet të përputhen me kohëzgjatjen e vëmendjes së fëmijëve, mund të filloni me 10 minuta pastaj me kalimin e kohës të rriten minutat.